



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Ferat Shala, nga fshati Buroje, 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

E PADITUR: REPUBLIKA E SERBISË –Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës
nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirimin nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 2296350 €

1). Paditësit me 11.05.1999 ne fshati Izbic ne vendin e quajtur lagja e boshnjakeve i janë vlarë vllëzrit; Xhevat dhe Milazim Shala nga ana e forcave paramilitare serbe nga afërsia, ndërsa nena Elheme Shala si pasoje e vrasjes se djemve ka mbet me trauma te luftës-çrregullime te përhershme psikike.

Provë : - Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës, nr. 580-71 ,e datës 20.01.2009
- Vërtetimet nga DSHMS – Skenderaj 09 nr.580 te datës 15.01.2009 mbi vrasjen e Xhevat dhe MilazimR.Shala si civil te luftës
- Raportet e specialistit psikiatër për çrregullim psikik te Elheme Shala i dt.20.08/09 NP.1042/09
- Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL-72015007-00077 te datës 12.01.2009
- Deklaratat për bashksin familjare nene nr.rendor 03/1-181/35 e dt.14.01/09
- Vërtetimi i D.per Urbanizëm nr.325-33 i dt.12.01.2009

2.) Paditësi se bashku me 17 anëtarët e familjes është detyruar ta braktis shtëpinë nga data 11.05.2009,date kjo kur i janë vlarë vllëzrit si me lart, shkon ne Republikën e Shqipërisë ku qëndron ne qytetin e Elbasanit plot nje vit, Si pasoje e luftës paditësit i vrahën 2 vëllezër Xhevati dhe Milazim,i digjet-shkatërrohet shtëpia e banimi ne sipërfaqe prej 234 m² si dhe oda e burrave ne sipërfaqe prej 50 m², i plaçkitet traktori i tipit universal me makinat përcjellëse si dhe mulliri shtëpiak, i është djegur po ashtu edhe

stalla e bagtise ne sipërfaqe prej 20m², koshi me plot misër si dhe ushqimi i bagëtisë ne sasi prej 4 stogj san.i është vlarë 1 lopë dhe qen ,djersa i janë dëmtuar 70 cop pula.
Dëshmitarët e ngjarjes: 1.Qazim Shala nga fsh.Buroje dhe 2. Shaban Sahiti fsh.Buroje

3.) Të drejtën për kompensim paditësi e bazon në nenin 185 te LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 te te njëjtit Ligj , me te cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë te personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qen e obliguar te pengoj aktet e vrasjes , dhunës, terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes se pasurisë se paditëses .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (neni 1 Protokolli nr. 1 , neni 2 dhe protokolli nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon qe kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor te çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bjen këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesë padija e paditësit Ferat Shala nga fshati Buroje , 41000

Skenderajt Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbisë - Qeveria e R.S. si pasardhëse juridike e Qeverisë se me parshme qe ne emër te te njëjtës te kompensoj demin material dhe jo material paditësit Ferat Shales ,nga f.sh. Buroje, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumen prej 1.600 000 €për vrasjen e 2 vëllezërve
- shumen prej 25 000 për çrregullime psikike te nenës
- shumen prej 163 200 €për dhembjen shpirtërore dhe te munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi ne qiell te hapur dhe shtëpi te huaja ne kohëzgjatje prej 12 muaj
- shumen prej 50 000 për shkak te pamundësuarit e krenimit te festave fetare ne shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes se kontaktit me farefis dhe te afërmit
- shumen prej 426 000 €për shtëpinë dhe oden e djegur dhe te shkatrruar,
- shumën prej 14 500 € për ter teknikën e bardhe në sallon dhe mobilerin e 8 dhomave te gjumit.
- Shumen prej 17 650 € për ;traktorin me makina përcjellëse dhe mullirin shtëpiak,pastaj s'tallen me koshin me miser dhe ushqimin e kafsheve si dhe per lopën,qenin e vrar dhe dëmtimin e shpezëve si ne kerkes
- shumën prej _____ €për pamundësin e punimit të tyokës bujqesore për një vit .

te gjitha këto shuma me kamat ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

1.) të bihet :

2.)

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit te paditëses në ter çështjen juridike mbi lirim nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysh gjendjen e vështir ekonomike te paditëses ne kuptim me nenin te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .
Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi

Ferat Shala



Shtojcë ;

1. Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës, nr. 580-71 ,e datës 20.01.2009
2. Vërtetimet nga DSHMS – Skenderaj 09 nr.580 te datës 15.01.2009 mbi vrasjen e Xhevat dhe Milazim R.Shala si civil te luftës
3. Raportet e specialistit psikiatër për çrregullim psikik te Elheme Shala i dt.20.08/09 NP.1042/09
4. Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL-72015007-00077 te datës 12.01.2009
5. Deklaratat për bashksin familjare nene nr.rendor 03/1-181/35 e dt.14.01/09
6. Vërtetimi i D.per Urbanizëm nr.325-33 i dt.12.01.2009
7. 4 kopje te padisë